



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA HANI I ELEZIT

Nr. i Prot. 08/479

Data: 21.01.2025

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM
RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024

Hani i Elezit
Janar, 2025

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit kalendarik 2025, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm ka marrë pjesë në të gjitha takimet, konferencat dhe punëtoritë që i përkasin sferës së zhvillimit ekonomik dhe atij turistik me interes për Komunën e Hanit të Elezit.

Gjatë këtij këtij viti, në kuadër të drejtorisë janë hartuar këta projekte:

Numri	Emri	Projekti
01	Ndërtimi i Ballkonit Panoramik tek shkronjat e UÇK-së	Ky projekt përfshinë rregullimin e hapësirës tek shkronjat e UÇK-së, hapësirë e dedikuar si pikë vrotimi, vendnalime për vetura dhe zonë të përbashkët për qëndrim. Vlera që arrinë ky projekt është afër 48,000.00 €.
02	Ndërtimi i parkut “Tek Pishat” në fshatin Gorancë	Ky projekt parasheh rregullimin e hapësirës në zonën e quajtur “Tek Pishat” në fshatin Gorancë, ku parashihen të vendosen ulëse, shtigje të ecjes, kënde të lojrave për fëmijë dhe shumë zona tjera rekreative dhe sociale. Vlera e këtij projekti parashihet të jetë rreth 90,000.00 €.
03	Rregullimi i këndit të lodrave në qendër të qytetit	Është projekt në të cilën janë paraparë të vendosen lodra për fëmijë, ulëse dhe gjelbërim të lartë. Kjo kërkesë është drejtuar tek KFOR dhe vlera e tij arrinë diku rreth 5,000.00 €.
04	Dizajnimi i brendshëm i strukturave tek parku “Isa Berisha”: 1. Dizajnimi i Muzeut të Qytetit” 2. Dizajnimi i Galerisë së Arteve” 3. Hapësirë e përbashkët për diskutime dhe evente	Është hartuar projekti për dizajnimin e brendshëm të tre strukturave në parkun “Isa Berisha” ku vlera totale është paraparë që të jetë rreth 220.000.00 €

Gjatë kësaj periudhe drejtoria ka organizuar evente të ndryshme me qëllim të zhvillimit dhe emancipimin në sektorin e zhvillimit ekonomik. Disa aktivitete të tjera kanë përfshirë:

- Kemi marrë pjesë në Paniairn Ndërkombëtar për Turizëm dhe Sport, ku me këtë rast janë prezantuar potencialet zhvillimore që ka Hani i Elezit në këto dy fusha.

- Kemi organizuar një Sesion Informues me AZHR Lindje rreth granteve që Ministria e Zhvillimit Rajonal shpërndanë.
- Gjatë kësaj periudhe gjithashtu është nënshkruar një Marrëveshje Mirëkuptimi me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, me qëllim të promovimit dhe përkrahjes së sektorit privat dhe ekonomisë lokale në përgjithësi.
- Gjithashtu gjatë këtij gjashtëmujori janë shpërndarë aktvendimet për vitin 2024, të taksës për ushtrim të veprimtarisë së bizneseve lokale.
- Për nder të 8 marsit, ditës së guras, bizneseve që udhëhiqen nga gratë u është përcjellë kartolinë e personalizuar dhe lule, në mënyrë për të treguar mbështetjen për sektorin privat.
- Gjatë këtij viti gjithashtu është publikuar dhe ka filluar implementimi i Strategjisë Për Zhvillim Ekonomik 2024-2028 Hani i Elezit, në të cilën parashihen aktivitete të shumta në secilin sektor zhvillimor.
- Janë hartuar dokumenta promovuese për Komunën me anë të kodeve Scan dhe janë prezantuar në panaire dhe evente të ndryshme. Në këtë pjesë, bënë pjesë edhe dizajnimi i fletushkave të tjera promovuese.
- Gjatë 2024, drejtorja ka përmbushur objektivin e saj kryesore e cila parasheh mbështetjen e sektorit privat me grante, mbështetje kjo e cila është realizuar në kuadër të Thirrjes Publike për Subvencionimin e Bizneseve StratUp dhe atyre Ekzistuese për vitin 2024. Në kuadër të kësaj thirrje janë mbështetur gjithsej 5 biznese, vlera e së cilës ka qenë shuma prej 10,000.00 €.
- Gjatë këtij viti, për tre muaj është realizuar kampanja digjitale për promovim, “Kartolinë nga Hani i Elezit”, ku përmes artit dhe fotografisë janë prezantuar potencialet zhillimore që ka vendi. Gjatë saj janë organizuar gjithashtu edhe ekspozitë në art me nxënësit më të dalluar në këtë fushë.
- Si bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë realizuam takime me bizneset lokale ku këta të fundit adresuan kërkesat e tyre kundrejt insitucionit.
- Është përgatitur koncepti i projektit për aplikim në thirrjen e re të granteve evropiane IPA III.
- Organizuam sesionin informues për bizneset lokale dhe të rinjët e Hanit të Elezit rreth punës praktike në sektorin privat përmes programit “Kosovo Generation Unlimited si bashkëpunim me Kosovo CSR.
- Kemi mbajtur takime të shpeshta me bashkëpërfituesit e programit IPA, me të cilët janë koordinuar aktivitetet që do të realizohen në kuadër të projektit A Smart System for Early Flood Detection on the Lepenci River Basin.

SEKTORI I TAKSAVE PËR USHTRIM TË VEPRIMTARISË

Inspektimet Janar-Dhjetor 2024	40
Gjobat	02
Aktvendimet dhe shpërndarja e tyre tek subjektet aktive	220
Faturat e lëshuara gjatë viti 2024	50
Faturimi për vitin 2024	97,610.68
Inkasimi për vitin 2024	76,589.88

Përshkrimi	Periudha Kohore	Viti 2024	Viti 2023
------------	-----------------	-----------	-----------

TAKSË PËR USHTRIM TË VEPRIMTARISË	Janar-Dhjetor	76,589.88 €	72,250.94 €
-----------------------------------	---------------	-------------	-------------

QENDRA PËR REGJISTRIM TË BIZNESEVE

Drejtoria në kuadër të saj ka edhe Qendrën për Regjistrim të Bizneseve e cila kryen të gjitha shërbimet sa i përket bizneseve lokale.

Sipas statistikave që Drejtoria ka, në Qendrën për Regjistrim të Qytetarëve që nga fillimet e saj e deri më tani janë të regjistruar 391 biznese, nga ku: 234 prej tyre i takojnë atyre Individuale (B.I), 156 biznese SHPK dhe 1 biznes SHA.

○ APLIKIME PËR BIZNESE TË REJA

Përshkrimi	Lloji	Numri	Totali 2024	Gjinia
Regjistrim biznesi	Biznese individuale / B.I	16	16 BI	06 / M
Regjistrim biznesi	Biznese Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara / SH.P.K	19	19 ShPK	29 / F

○ APLIKIME PËR SHUARJE TË BIZNESEVE

Përshkrimi	Lloji	Numri	Totali 2024	Gjinia
Shuarje të bizneseve	Biznese individuale / B.I	6	6 BI	4 F
Shuarje të bizneseve	Biznese Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara / SH.P.K	0	0 SHPK	2 M

○ APLIKIME PËR NDRYSHIME NË BIZNES

Përshkrimi i shërbimit	Totali
Kërkesë për informata	73
Kërkesë për ndryshimin e pronarëve /aksionarëve	4
Kërkesë për shtimin apo heqjen e aktivitetit	3
Kërkesë për ndryshim të adresës	4
Kërkesë për ndryshimin e drejtorit apo përfaqësuesit të autorizuar	3
Kërkesë për ndryshim të emrit tregtarë	0

Kërkesë për ndryshim të bordit	0
Kërkesë për shuarje të njësisë	3
Kërkesë për certifikatë dublikat	4

Majlinda Kaloshi
Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm